

## STATUT

### I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "AGRO POLIS" Sh.p.k.

Në këtë statut:

- "Ligji" është Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Trëgtare", i ndryshuar,
- "Statuti" është Statuti i Shoqërisë;
- Shoqëri është Shoqëria "AGRO POLIS" Sh.p.k.

#### KREU I

#### THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

#### NENI 1

#### DATA E THEMELIMIT, EMRI DHE THEMELUESIT

1. Sot, më datë 07.01.2020 ne, themeluesit, kemi krijuar Shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emrin "AGRO POLIS" sh.p.k.
2. Themeluesit e Shoqërisë "AGRO POLIS" sh.p.k janë:

Z. Jonaid MYZYRI, i biri i Abdyl dhe i Aida, i datëlindjes 27.06.1990, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë mbajtës i letërnjoftimit me Nr. 033902833 dhe Nr. Personal J00627077O

Z. Gëzim Fezolli, i biri i Myzafer dhe i Myrvete, i datëlindjes 13.07.1954, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë mbajtës i letërnjoftimit me Nr. 033908762 dhe Nr. Personal F40713027E



## NENI 2 OBJEKTI

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë si më poshtë vijon:

Krijimi i hapësirave rekreative për agro-turizëm, bar, restorant, hotel, fermë, sera etj. Grumbullim, prodhim dhe tregtim i frutave, perime, qumështit, djathit dhe nënprodukteve të tyre. Përpunim i fruta-perimeve. Prodhim dhe tregëtim i verës dhe pijeve të tjera alkoolike. Kantinë vere dhe distileri. Tregtim i mishit dhe nënprodukteve të tij.

Ofrimi i shërbimit katering. Prodhim dhe shitja e bukës. Import-Eksport dhe tregtim i pijeve freskuese, alkoolike, si dhe të gjitha produkteve të tjera ushqimore.

Tregtim i farave, fidanëve, bimëve luleve dhe bimëve të ndryshme, bimëve mjekësore dhe shafranit.

Organizimi i eventeve, konferencave, takimeve, B2B, Panairove. Shërbimet e ndërmjetësit të kompanive shqiptare jashtë shtetit apo kompanive të huaja në tregun shqiptar; Përfaqësimi i markave ndërkombëtare dhe tregtimi i të gjitha llojeve të produkteve përfshirë pije dhe ushqimin.

Organizimi i aktiviteteve të turizmit, kulturore dhe sportive. Organizim i guidave turistike por pa u kufizuar në të për turizmin malor, bregdetar dhe atë kulturor.

Krijimi hapësirave për artizanët, pocerit, qendistari, zdrukhtari etj;

Prodhim dhe tregtim i duhanit, cigareve, cigarollo dhe puro.

Organizim i kurseve profesionale në fushën e hoteleri turizmit dhe kurse profesionale gatimi.

Ndërtim i godinave civile dhe industriale.

Prodhim dhe shitje e energjisë së rinovueshme.



### NENI 3

#### KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë për një afat të pa përcaktuar.

### NENI 4

#### SELIA DHE VENDET E USHTRIMIT TË AKTIVITETIT

1. Selia e Shoqërisë ndodhet ne adresën: Rruga "Sami Frashëri, Pallati Titan Construction Kati 4, Ap 7, Tiranë"
2. Shoqëria mund të hap vende të ushtrimit të aktivitetit të saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, të krijojë degë dhe përfaqësi jashtë Republikës së Shqipërisë, si edhe të themelojë apo të jetë aksionere/ortake në subjekte të tjera juridike. Vendimarrja në këto raste do ti nënshtrohet rregullave të këtij statuti.

### KREU II

#### KAPITALI

### NENI 5

#### KAPITALI THEMELTAR

1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 Lekë.
2. Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga dy kuota sipas kontributit të ortakëve themelues të shoqërisë si më poshtë vijon:

Jonaïd MYZYRI, është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 51,000 (pesëdhjetë e një mijë ) lekë, që përbën 51 % të kapitalit të shoqërisë.

Gëzim Fezolli është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 49,000 (dyzet e nëntë mijë ) lekë, që përbën 49 % të kapitalit të shoqërisë.

1. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).
2. Vlerësimi i kontributit të ortakëve në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta) do të bëhet sipas parashikimeve të Ligjit.

## NENI 6


### ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

1. Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe/ose me anë të kontributeve në natyrë.
2. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
3. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

## NENI 7

### TRANSFERIMI I KAPITALIT

1. Kuotat e kapitalit të Shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - d) dhurimit;
  - e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
2. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, dhe shoqërisë në përputhje me parashikimet e këtij statuti. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.
  - 2.1. Ortaku ka të drejtë që të largohet nga Shoqëria në çdo moment ose të shesë/transferojë një pjesë të kapitalit zotërues të tij. Ortaku i cili vendos largimin nga shoqëria ose shitjen/transferimin e një pjese të kapitalit zotërues njofton administratorin e shoqërisë për thirrjen e mbledhjes së jashtëzakonshme të Asamblesë së Ortakëve sipas kushteve të këtij statuti. Në këtë rast, administratori i shoqërisë njofton mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve duke përcaktuar:



- a) Numrin e kuotave në pronësi efektive të ortakut shitës, vlerën e përgjithshme dhe pjesën takuese në përqindje në përputhje me kapitalin e shoqërisë.
  - b) Numrin e kuotave, vlerën e përgjithshme të tyre dhe pjesën takuese në përqindje që përbëjnë kuotat e ofruara për shitje/transferim.
  - c) Kushtet e shitjes së kuotave dhe çmimin minimal të propozuar.
- 2.2. Ortaku i cili vendos të largohet, para shitjes/transferimit të kuotave i ofron fillimisht në favor të shoqërisë ose ortakëve të tjerë të shoqërisë të drejtën e parablerjes së tyre. Ortakët mund të vendosin në të njëjtën mbledhje në lidhje me parablerjen ose jo të tyre, ose mund të kërkojnë marrjen e një vendimi jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune.
- 2.3. Në rast se sipas vendimarrjes së Asamblesë së Ortakëve kuotat nuk transferohen me anë të shitjes në favor të shoqërisë ose ortakëve të tjerë të shoqërisë, atëherë ortakut shitës paraqet pranë Asamblesë së Ortakëve *Blerësin e Propozuar*.
- 2.4.1 Para realizimit të kontratës së shitje/blerjes me blerësin e propozuar Asambleja e Ortakëve mund të kërkojë informacion ose të kryejë hetime për blerësin e propozuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Asambleja e ortakëve vendos me vendimarrje të veçantë mbi transferimin e kuotave individëve ose personave juridikë në përputhje me këtë statut. Asambleja e Ortakëve nuk mund të refuzojë blerës të propozuar, veçse në rastin kur ka dyshime të arsyeshme se burimi i të ardhurave të blerësit të propozuar nuk është i ligjshëm dhe/ose mund të dëmtojë interes të shoqërisë në tërësi.
3. Në rast të transferimit të kuotave me anë të trashëgimisë (*mortis causa*) Asambleja e Ortakëve jep pëlqimin për ortakët e rinj. Asambleja e Ortakëve nuk mund të refuzojë trashëgimtarët, veçse në rastin kur ka dyshime të arsyeshme se pranimi mund të dëmtojë interes të shoqërisë në tërësi. Në këtë rast, vlera e shlyerjes, me anë të parablerjes ose likuidimit të kuotës do të vendoset nga gjykata kompetente. Kuota mund të anulohet në çdo rast me miratimin e ortakut përkatës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga statuti. Të drejtat e detyrimit, që i rrjedhin ortakut nga zotërimi i kuotës, shuhet me anulimin e saj.

## NENI 8

### LARGIMI I ORTAKUT PËR SHKAQE TË ARSYESHME

1. Ortaku mund të largohet nga shoqëria me vullnetin e tij ose nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.
2. Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtrijë shkaqet e largimit.
3. Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, sipas pikës 2 të këtij neni, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.
4. Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e Ortakëve nuk mblidhet apo nuk i njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.
5. Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.
6. Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrejë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërblimin e dëmit të pësuar.

## KREU III

### ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE

## NENI 9

### ORGANI VENDIMARRËS

1. Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë.
2. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
  - a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b. ndryshimet e statutit;



- c. ndryshimin e selisë;
- d. hapjen/mbylljen e aktiviteteve të tjera të shoqërisë brenda dhe jashtë vendit
- e. Themelimin e subjekteve të tjera juridike ose pjesëmarrjen në kapitalin e tyre.
- f. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- g. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- h. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "e" dhe "f" të kësaj pike;
- i. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- j. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- k. shpërndarjen e fitmeve vjetore
- l. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- m. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- n. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- o. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- p. emërimin ekspertit kontabël të autorizuar në përputhje me parashikimet e ligjislacionit në fuqi;
- q. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- r. përjashtimin e ortakut nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim;
- s. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

3. Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjen vijuese me të njëjtin rend dite.

4. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

## **NENI 10**

### **MËNYRA E THIRRJES SE MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME**

1. Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ligji, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e Shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën dy herë në vit.
2. Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë me njoftim Lajmërim –Marrje në adresën e ortakëve të shoqërisë dhe/ose në formë elektronike, në adresën zyrtare të e-mailit secilit prej ortakëve të shoqërisë. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
3. Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori ose ortakët e shoqërisë që përfaqësojnë shumicën e votave si edhe ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, në përputhje me parashikimet e ligjit.
4. Kur Asamblesë së Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 2 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë. Kjo pasqyrohet në proces-verbalin e vendimit të mbledhjes.

## **NENI 11**

### **KUORUMI**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur Asamblesë së Përgjithshme i duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave





janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të këtij statuti.

2. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## NENI 12

### MARRJA E VENDIMEVE

1. Asambleja e Përgjithshme vendos me **tri të katërtat e votave** te zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, themelimin e subjekteve të tjera juridike ose pjesëmarrjen në kapitalin e tyre si edhe mbi vendimarrjet e administratorit për tagrat e kufizuar sipas këtij statute dhe caktimin e personave që do të kryejnë hetime të posaçme ose inventarin e shoqërisë sipas rregullave të statutit
2. Asambleja e Përgjithshme vendos me unanimitet për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar.
3. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të pasqyruar ndryshimet në ekstraktin e shoqërisë.
4. Asamblesë së Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:
  - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve
  - e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; ngritjen e padive përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimeve të administratoreve, si pasoje e shkeljes së rëndë të ligjit ose të statutit dhe/ose padi të tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratoreve apo ortakeve.
  - g) Nisjen e hetimeve të posaçme sipas parashikimeve të Ligjit.
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

5. Ortaket, të cilët përfaqesojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë ose një vlerë më të vogël, të parashikuar në statut, dhe/ose kreditorët e shoqërisë, të cilët pretendojnë se shoqëria ka ndaj tyre detyrime në një vlerë jo më të vogël se 5 për qind të kapitalit, mund t'i kërkojnë asamblese se pergjithshme ngritjen e padise për shfuqizimin e vendimeve të administratorit në përputhje me Ligjin.

### **NENI 13**

#### **PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTËS**

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.


2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### **NENI 14**

#### **ADMINISTRIMI**

1. Administrimi i shoqërisë realizohet nga Administratori i vetëm i saj.
2. Afati i emërimit të administratorit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.
3. Emërimi i administratorëve, i cili hyn në fuqi në datën e percaktuar sipas aktit të emërimit, u kundërdrejtohet paleve të treta sipas percaktimeve të Ligjit.
4. Znj. Valbona Ndrepepaj, e datëlindjes 12.11.1989 lindur në Bajram Curri dhe banues në Tiranë madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar është administrator i parë i shoqërisë me afat emërimi nga 07.01.2020 deri më 07.01.2025

Nënshkrimi(emer mbiemer firme)






## NENI 15

### KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

1. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:
  - a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
  - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - e) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - f) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
  - g) raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut;
  - i) cdo lloj aktiviteti që lidhet me zbatueshmërinë e objektit të shoqërisë dhe pa tejkalar limitet e caktuara nga Asambleja e Përgjithshme.
1. Administratori raporton tek ortakët e shoqërisë nëpërmjet postes elektronike të certifikuar për cdo kontratë që nënshkruhet për sa vijon: Kontratë Pune, kontratë furnizimi dhe cdo kontrate tjetër përjashtuar kontratat e franchising. Administratori informon menjëhere ortakët për çdo mosmarrëveshje në kontratat që shoqëria disponon, zgjidhjen e tyre duke dhënë shjegime përkatëse dhe masat e marra në kuadër të mbrojtjes së interesit të shoqërisë.
2. Administratori është i detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në përputhje me parashikimet e Statutit dhe Ligjit.
3. Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme edhe në rastet se:

- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

## NENI 16

### PERGJEGJESITË E ADMINISTRATORIT

1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
2. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
3. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 13,14,15,16,17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar, administratori detyrohet:
4. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
5. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, si edhe në rast se vepron në tejkalim të kompetencave të dhëna nga Asambleja e Përgjithshme, për të cilat nuk ka vënë në dijeni Asamblenë dhe/ose nuk ka marrë miratimin përkatës në përputhje me Statutin, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.
6. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.



7. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
  - a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
  - e) jep kredi.
  - f) Vepron në tejkalim të kompetencave të dhëna nga Asambleja e Përgjithshme, për të cilat nuk ka vënë në dijeni Asambleshën dhe/ose nuk ka marrë miratimin përkatës në përputhje me Statutin. Shkaktimi i dëmit nuk përbën kusht për përgjegjësinë e administratorit.
8. Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.
9. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **KREU IV**

#### **VITI FINANCIAR-SHPËRNDARJA E FITIMEVE- EKSPERTËT**

#### **NENI 17**

#### **VITI FINANCIAR**

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përyjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

## **NENI 18**

### **SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

1. Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.
2. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.
3. Shpërndarja e fitimeve të shoqërisë bëhet në përputhje me parashikimet e Statutit dhe të Ligjit.

## **NENI 19**

### **EKSPERTËT FISKALË**

1. Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gje të tilla i ngarkuar nga ana e ortakëve.
2. Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për ato për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakut për t'i shqyrtuar e miratuar.

## **KREU V**

### **PRISHJA –RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

## **NENI 20**

### **PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

1. Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :
  - a) me vendim të Asamblese së Ortakëve;
  - b) me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë



3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"; i ndryshuar me ligjin nr.131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";

d) me vendim të gjykatës;

2. Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe shenuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoqëri në likuidim e sipër".
3. Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.
4. Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

## **NENI 21**

### **RIORGANIZMI I SHOQËRISË BASHKIMI-NDARJA**

1. Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendim të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.", të ndryshuar.
2. Shoqëria mund të shndërrojë formën e vet ligjore në përputhje me parashikimet e Ligjit.

## **NENI 22**

### **BAZA LIGJORE**

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.
2. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.


**NENI 23**

**MOSMARRËVESHJET**

Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.

**ORTAKËT E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR:**

Jonaïd MYZYRI



Gëzim FEZOLLI

